

VENDIM
Nr.43, datë 18.11.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	”””
Manol Konomi,	Anëtar i	”””
Veli Budo,	Anëtar i	”””
Zija Vuci,	Anëtar i	”””
Franc Jakova,	Anëtar i	”””
Alfred Karamuco,	Anëtar i	”””

me sekretare Drita Filto në datën 13.11.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 46 Akti që i përket:

KËRKUES: NAIM PEÇI, i përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj.

PALË TË INTERESUARA:

1. PANDELI ZHULI, i përfaqësuar nga Ilia Selo.
2. NIKO GEGA
3. MAKSIM BALA

O B J E K T I:

Deklarimi antikushtetues i vendimeve nr.1641, datë 20.12.1995, nr.8, datë 5.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër dhe nr.2329, datë 25.4.1996 të Gjykatës së Apelit, si dhe shfuqizimi i urdhërit ekzekutiv nr.147, datë 6.10.1996 të Zyrës së Përmbartimit Gjyrokastër.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuarit, palët e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Në gjykimin e çështjes civile, me objekt kthimin e shumës prej 117.000 USD, me paditës Pandeli Zhuli dhe të paditur Naim Peçi, Gjykata e Rrethit Gjyrokastër me vendimin nr.1641, datë 20.12.1995 ka vendosur pranimin e padisë.

Mbi ankimin e të paditurit, çështja është shqyrtuar në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit, e cila me vendimin nr.2329, datë 25.04.1996, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me këto vendime, kërkuari në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes nga kjo Gjykatë ka parashtruar se i janë prekur të drejtat e tij themelore për një proces të rregullt ligjor sepse çështja ka qenë jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Për të mbështetur këtë parashtrim ai ka pretenduar se si paditësi dhe ai i paditur janë shtetas amerikanë, se veprimi juridik nga buron detyrimi është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, se palët s'kanë pasur marrëveshje për të drejtën që do zbatohet dhe se marrëveshja është thjeshtë për një shoqëri të krijuar në Amerikë e për pasojë, ligji që duhet të zbatohet ishte ai amerikan.

Gjykata Kushtetuese, konstaton se këto pretendime kërkuari i ka parashtruar si prapsime në gjykimin e çështjes në gjykatën e faktit dhe në atë të Apelit, e ato nuk i janë pranuar. Ato kanë karakter ligjor e për pasojë ato parashtrohen nëpërmjet ankimit vetëm në Gjykatën e Kasacionit, si shkalla më e lartë që shqyrton ligshmërinë e vendimeve gjyqësore. Sa ngre kërkuari, nuk përbëjnë problem me karakter kushtetues e për pasojë, ato nuk janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.

2. Në gjykimin e çështjes civile me objekt kthimin e shumave të marra si garanci në disa kontrata furnizimi me ekskluzivitet, me paditës Niko Gega etj., dhe të paditur Shoqërinë "Glina" Sh.P.K., me president dhe ortak të vetëm Naim Peçin Gjykata e Rrethit Gjyrokastër me vendimin nr.8, datë 05.01.1996 ka vendosur pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi kërkuari nuk është ankuar në instancat më të larta gjyqësore.

Në lidhje me këtë vendim, kërkuari pretendon se ai është rezultat i një procesi jo të rregullt për

shkak se gjykata nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit, është shkelur e drejta e mbrojtjes dhe se është disponuar mbi objektin e padisë.

Gjykata Kushtetuese pasi shqyrtoi të gjitha dokumentat shkresore, pasi dëgjoi në seancë shpjegimet e një sërë personave, arrin në konkluzionin se pretendimet për një proces jo të rregullt ligjor janë të pabazuara.

Në radhë të parë, nga shpjegimet e Z.Maksim Bala si përfaqësues i shtetit në Shoqërinë "A.A.Glina" Sh.P.K., Z.Niko Gega si përfaqësues i paditësve, të avokatit Bashkim Asllani si dhe nga teksti i marrëveshjes datë 20.12.1995 e nga vendimi i Këshillit të Ortakëve datë 25.12.1995 del e provuar se kërkuesi ka pasur dijeni për padinë e ngritur e gjykimin e saj.

Pjesëmarrja e avokatit në këtë gjyq, nuk është bërë pa dijeni e pa autorizim të kërkuesit. Avokati Bashkim Asllani ka pasur nga kërkuesi një prokurë të përgjithshme, lëshuar në datën 6 maj 1994 (e cila është pa afat) dhe që nuk del të jetë revokuar deri në mars të vitit 1996.

Në kërkesë ngrihet se avokati Bashkim Asllani, në kundërshtim me detyrën e tij si mbrojtës i interesave të Naim Peçi si i paditur ka pranuar shpërblime nga paditësit nëpërmjet një kontrate.

Të pyetur në seancë gjyqësore avokati e përfaqësuesi i paditësve, pranuan se edhe pse çështja kaloi në gjyq, pranimi i detyrimit nga Naim Peçi dhe modalitetet e shlyerjes u vendosën me pajtim nga palët, në prezencë edhe të ortakut shtetëror dhe për shpërblimin e avokatit u ra dakord nga të gjithë palët duke përfshirë edhe Z.Naim Peçi. Këto shpjegime, rreth shpërblimit të avokatit, të bëra gjatë seancës gjyqësore Z.Naim Peçi nuk i kundërshtoi.

I pabazuar mbetet edhe pretendimi për disponim të paligjshëm nga ana e avokatit mbi objektin e padisë. Gjykata konstaton se avokati nuk ka pasur prokurë të posaçme për të zgjidhur çështjen me pajtim, por veçse nuk del gjithashtu se çështja është zgjidhur në këtë formë përkundrazi, vendimi ka në dispozitiv detyrimin e "Glina" Sh.P.K. t'u kthejë paditësve shumat e marra. Fakti që avokati në gjykim ka pranuar detyrimin nuk do të thotë disponim mbi objektin e padisë, për më tepër në rrethanat kur dhe vetë kërkuesi i paditur në një dokument noterial, të hartuar disa ditë para gjyqit e ka pranuar detyrimin.

3. Në kërkesën e tij kërkuesi Naim Peçi ngre probleme edhe përse i përket fazës së ekzekutimit të vendimeve.

Gjatë shqyrtimit të çështjes ka dalë se Zyra e Përmbarimit Gjirokastër, ka vënë në ekzekutim dy vendimet gjyqësore të sipërpërmendura dhe një sërë titujsh të tjerë ekzekutivë. Debitori dhe çdo person i tretë kur çmojnë se nga veprimet e përmbaruesit gjyqësor preken të drejtat e tyre subjektive, në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

- Të hiqet masa e pezullimit të ankandit, urdhëruar në datën 21.10.1996.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIM NË PAKICË

Nuk pajtohem me vendimin e dhënë nga shumica e Gjykatës Kushtetuese vetëm përse i përket rrëzimit të kërkesës për shpalljen antikushtetues të vendimit nr.8, datë 5.1.1996 të gjykatës së rrethit Gjirokastër.

Duke marrë parasysh se në kontratën e lidhur me datën 20.12.1995 midis kërkuesit Naim Peçi e kreditorëve të tij Qirjako Bali etj., dhe e vërtetuar nga noteri më datë 3.1.1996, janë përcaktuar mënyra e përmbushjes së detyrimit nga kërkuesi si debitor dhe masat e nevojshme organizative-administrative, për sigurimin e përmbushjes së detyrimit,

Duke marrë parasysh se palët në kontratën e mësipërme, për të garantuar më mirë të drejtat e kreditorëve, kanë shprehur pëlqimin e tyre për gjykimin e çështjes me pajtimin e palëve në gjykim dhe

me marrjen e masave të nevojshme të sigurimit deri në shlyerjen e detyrimit,

Duke marrë parasysh se vendimi nr.8, datë 5.1.1996 i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, është dhënë vetëm dy ditë pas vërtetimit të kontratës me kërkesën e palëve nga noteri dhe se brenda këtyre dy ditëve nuk ka lindur asnjë shkak për dhënien e një vendimi të tillë detyrimi,

Duke marrë parasysh se vendimi i gjykatës , nuk është dhënë mbi bazën e pajtimit midis palëve kontraktuese, ashtu siç parashikohej në kontratë, por urdhëron vetëm kthimin e të hollave, jashtë dhe në kundërshtim me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga palët në kontratë,

Duke marrë parasysh se paditësat në atë kohë nuk legjitimoheshin në ngritjen e një padië detyrimi, pasi nuk kishte lindur interesi për të justifikuar ligjërisht kërkimin e kreditorëve dhe mungonte shkak i padisë së detyrimit, që është një gjendje fakti që i kundërvihet së drejtës subjektive të tyre pas lidhjes së kontratës,

Duke marrë parasysh se avokati që ka marrë pjesë në procesin gjyqësor me cilësinë e përfaqësuesit të kërkuarit, ka disponuar lidhur me të drejtën e padisë, duke e pranuar atë pa e pasur këtë tagër në prokurën e përgjithshme,

Duke marrë parasysh se vendimi i gjykatës së rrethit që detyron të paditerin t'u kthejë kreditorëve shumat e caktuara, i shfuqizon të gjitha kushtet e parashikuara në kontratën e lidhur midis palëve, pa pëlqimin e të paditurit,

Arrij në përfundim se vendimi nr.8, datë 5.1.1996 i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër duhet të shpallet antikushtetues për arsye se nga shkeljet e mësipërme, të paditurit i është cenuar e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor (neni 38 i ligjit Kushtetues për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut")"

KRYETARI
Rustem Gjata